



Instituti Gjyqësor i Kosovës
Kosovski Institut za Pravosudje
Kosovo Judicial Institute

BULETINI



Përmbajtja

***Aktivitetet nga Programi
i Trajnimit të Vazhdueshëm
(PTV)***

***Aktivitetet nga Programi
i Trajnimit për Avancim
(PTA)***

***Aktivitetet nga Programi i
Trajnimit Fillestar (PTF)***

Aktivitetet tjera

***Adresa: Lagjja e Spitalit
Rr. "Muharrem Fejza" p. n.
Prishtinë, Republika e Kosovës
infokji@rks-gov.net
<http://igjk.rks-gov.net>***

**Ne nuk bëjmë drejtësi
Ne e bëjmë drejtësinë më të mirë**

Aktivitetet nga Programi i Trajnimit të Vazhdueshëm (PTV)

Trajnim “ Ligji për mbrojtjen nga dhuna në familje - aktet nënligjore, bashkëpunimi i akterëve të drejtësisë dhe institucioneve të ndryshme në mbrojtje nga dhuna në familje”

Me 1 dhe 3 korrik 2013, IGJK në bashkëpunim me UNDP/WSSI Plus, ka mbajtur trajnimin me temën e lartpërmendur.

Gjatë këtij trajnimi u trajtuan çështjet në lidhje me procedurën civile për mbrojtjen nga dhuna në familje, roli i gjyqtarit penalist gjatë shqyrtimit dhe vendosjes lidhur me veprat penale që lidhen me dhunën në familje si dhe roli i prokurorit të shtetit në çështjet lidhur me mbrojtjen e viktimave të dhunës na familje.

Në veçanti u shqyrtua Udhëzimet Administrative Nr. 12/2012 dhe Nr. 02/2013 për mënyrën e trajtimit të kryesve të dhunës në familje ndaj të cilëve shqiptohen masat mbrojtëse të trajnimit të obligueshëm mjekësor nga varësia e alkoolit dhe substancave psikotrope. Trajnimi u realizua përmes diskutimeve interaktive dhe rasteve praktike lidhur me temat e trajtuara.

Pjesëmarrës në këtë trajnim ishin gjyqtarët e divizioneve të ndryshme nga Gjykatat Themelore të Regjionit të Pejës, Gjakovës dhe Prizrenit, Gjilanit dhe Ferizajit.



Tryeza të diskutimeve “Ndërmjetësimi në çështjet civile”

IGJK me 01 dhe 02 korrik 2013 ka mbajtur dy tryeza të diskutimeve me dy grupe të ndryshme të pjesëmarrësve, me temë “Ndërmjetësimi në çështjet civile”

Këto tryeza qëllim kryesor kishin avancimin e njohurive të gjyqtarëve në lëmin e zbatimit praktik të ndërmjetësimit si metodë efektive për zgjidhjen e konflikteve.

Gjatë kësaj tryeze u shtjelluan çështjet që kanë të bëjnë me natyrën juridike të ndërmjetësimit, qëllimet dhe metodat e ndërmjetësimit në rastet civile, strategjia e komunikimit në rastet gjyqësore, rregullat e komunikimit në gjykatë dhe ndërmjetësim, përparësitë e ndërmjetësimit dhe rastet jo të përshtatshme për ndërmjetësim. Gjerësisht u trajtua

edhe raporti në mes të ndërmjetësimit dhe mekanizmave tjerë për zgjidhje alternative të kontesteve, dispozitave ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare për ndërmjetësim, marrëveshja për ndërmjetësim, efektet ligjore të saj si dhe roli dhe përgjegjësia e ndërmjetësuesve.

Përfitues ishin gjyqtarët e departamenteve të përgjithshme-divizioneve civile në të gjitha gjykatat themelore dhe ndërmjetësuesit nga të gjitha Qendrat e Ndërmjetësimit në Kosovë.

Përmirësimi i cilësisë të hetimeve të korrupsionit – të ndër-agjencive financiare dhe ndërkombëtare



Më 1, 2, 3, 8, 9 dhe 10 korrik 2013, IGJK në bashkëpunim me RIPA Internacional, ka realizuar disa sesione trajnuese me temën e lartpërmendur.

Qëllimi i trajnimit ishte përmirësimi i cilësisë dhe efektshmërisë së hetimeve financiare të lidhura me çështjet e korrupsionit si dhe forcimi i qasjes bashkëpunuese për hetimet ndërmjet agjencive të zbatimit të ligjit brenda Kosovës dhe në nivel ndërkombëtar.

Përmes qasjes bashkëkohore të mësimdhënies për të rritur dhe përdorimit të teknikave inter-aktive të trajnimit nga ana e trajnuesve ndërkombëtare u trajtuan analizat strategjike, vendosja e prioriteteve dhe objektivat - rezultatet në menaxhimin e informacionit dhe inteligjencës së zbulimit. Në fokus

të trajnimit ishte edhe menaxhimi i performancës organizative dhe shkëmbimi i përvojave në mes zyrtarëve të institucioneve vendore dhe atyre në Mbretërinë e Bashkuar. Po ashtu u diskutua për tejkalimin e pengesave dhe u analizuan mundësitë për ngritjen e efektshmërisë së punës ndërmjet agjencive. Një rëndësi e veçantë, në këtë trajnim, iu kushtua hetimeve financiare. Pjesëmarrësit përmes rasteve hipotetike patën mundësinë që të analizojnë metodat aktuale të hetimit financiar në Kosovë dhe diskutojnë për mundësinë e përmirësimit dhe avancimit të praktikave të tilla.

Përfitues të trajnimit ishin gjyqtarët nga gjykatat themelore dhe prokurorët nga prokuroritë themelore, zyrtarë doganierë, të policisë së Kosovës dhe të Agjencionit të Anti-korrupsionit.



Tryezë diskutimesh -“Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore”

Më 2 korrik 2013, IGJK realizoj një tryezë diskutimesh me temë “Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte zbutja e pengesave të shumta që paraqiten në praktikë e sidomos në situatat kur ato vendime janë të plotfuqishme në rastet e ekzekutimeve me burg, por edhe atyre me gjobë.

Gjatë këtij trajnimi u analizuan çështjet praktike që kanë të bëjnë me ekzekutimin e dënimeve kryesore, dënimeve plotësuese dhe alternative, ekzekutimi i vendimit për shpenzimet procedurale, konfiskimi i dobisë pasurore, kërkesave pasurore juridike dhe korrigjimi i vendimeve të ekzekutueshme. Trajnimin e përshkoi trajtimi i rasteve nga praktika dhe shkëmbimi i përvojave.

Përfitues të këtij trajnimi ishin kryetarë të gjykatave dhe gjyqtarë nga të gjitha regjionet e Kosovës.

Tryezë diskutimesh “Ndërmjetësimi në çështjet penale”



Më 3 dhe 4 korrik 2013, IGJK në bashkëpunim me IRZ ka organizuar dy tryeza të diskutimeve nga lëmia penale me temën “Ndërmjetësimin në çështjet penale”.

Gjatë trajnimit pjesëmarrësit patën mundësi që të njihen me natyrën juridike të ndërmjetësimit, qëllimet dhe metodat e ndërmjetësimit në rastet penale. Vëmendje parësore iu kushtua strategjisë së komunikimit të palëve të cilat kanë pranuar që çështja e tyre të zgjidhet me ndërmjetësim si dhe rregullat e komunikimit që duhet respektuar gjatë ndërmjetësimit. Po ashtu rëndësi e veçantë ju kushtua edhe çështjes së konfliktit dhe rolit të ligjit, avantazhet e ndërmjetësimit dhe rastet jo të përshtatshme për ndërmjetësim.

Trajnimit e përshkoi trajtimi i rasteve nga praktika dhe shkëmbimi i përvojave ndërmjet pjesëmarrësve të profileve të ndryshme.

Përfitues të kësaj tryeze ishin dy grupe të gjyqtarëve nga gjykatat themelore të regjioneve të ndryshme të vendit si dhe një numër i ndërmjetësuesve.

Forcimi i Bashkëpunimit Juridik Ndërkombëtar



Më 8-9 korrik 2013, IGJK në bashkëpunim me Projektin e Binjakëzimit i financuar dhe menaxhuar nga zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë realizoi një trajnim dy ditor të radhës me temë “ Forcimi i Bashkëpunimit Juridik Ndërkombëtar”

Qëllimi i këtij trajnimi ishte krijimi i praktikave më të mira në drejtim të bashkëpunimit ndërkombëtar dhe diskutimit të përbashkët të projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-31 për Bashkëpunimin Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale.

Gjatë trajnimit u diskutua për parimet themelore të bashkëpunimit juridik ndërkombëtar, praktikën e ligjit të ri për bashkëpunimin juridik ndërkombëtar, parimet themelore në ekstradim dhe principet themelore të transferimit të procedurës penale dhe transferimin e personave të gjykuar. Gjithashtu u trajtuan edhe çështje nga projekt ligji i Kosovës për Bashkëpunimin Juridik Ndërkombëtar, Urdhër Arresti Evropian, Urdhri për Ngrirje, Urdhri për konfiskimin e pasurisë të cilat drejtpërdrejtë veprojnë mes shteteve dhe lehtësojnë procedurat përkatëse.

Në ditën e dytë pjesëmarrësit patën rastin që përmes një rasti praktik me element ndërkombëtar të demonstrojnë njohuritë e tyre lidhur me hapat që duhet ndërmarrë për realizimin e procedurës. Pas përfundimit të trajnimeve pjesëmarrësit e caktuar si persona kontaktues për çështjet e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar kanë realizuar takime regjionale me qëllim të koordinimit dhe zhvillimit të bashkëpunimit juridik ndërkombëtar. Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarët dhe prokurorët e caktuar si persona kontaktues në çështjet e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar.

Seminar - "Gjykimet e Mosmarrëveshjeve Ndërkombëtare Tregtare"



Më 8 dhe 9 korrik 2013, IGJK në bashkëpunim me CLDP, ka mbajtur seminarin me temën e lartpërmendur.

Qëllimi i seminarit ishte avancimi i profesionalizmit tek gjyqtarët e Kosovës lidhur me gjykimin e drejtë, efikas dhe efektiv të mosmarrëveshjeve ndërkombëtare tregtare dhe marrjen e gjykimeve të harmonizuara dhe efikase, kur për objekt kanë kontratat e shitjes ndërkombëtare.

Përmes përdorimit të teknikave inter-aktive të trajnimit nga ana e trajnuesit ndërkombëtar u trajtua Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi Kontratat për Shitjen e Mallrave (CISG) lidhur me qasjen dhe rolin e saj në rritjen e sigurisë brenda kontratave të shitjes ndërkombëtare. Po ashtu u diskutua edhe për Konventën e Nju Jorkut dhe rëndësia e njohjes së saj nga ana e gjyqtarëve të Kosovës. Krahas konventave të lartpërmendura, në këtë seminar u analizuan edhe rregullat dhe praktikatat tjera të zakonshme që mund të ndikojnë në transaksionet ndërkombëtare komerciale, letrat e kredit që përfaqësojnë një praktikë standarde ndërkombëtare të biznesit dhe një prej metodave më të sigurta të financimit të tregtisë ndërkombëtare. Më tutje në fokus të seminarit ishte edhe të kuptuarit dhe shfrytëzimi i INCOTERMS, termave të para-përcaktuar komercial të botuar nga Oda Ndërkombëtare e Tregtisë.

Përfitues të trajnimit ishin gjyqtarët nga departamenti ekonomik dhe i përgjithshëm i gjykatave themelore dhe departamenti ekonomik i Gjykatës së Apelit.

Trajnim "Ligji për konfiskimin, ngrirja e aseteve dhe pastrimi i parave"



Me 11 dhe 12 korrik 2013, IGJK në bashkëpunim me RIPA Internacional, organizoi trajnimin dy ditor me temën e lartpërmendur.

Gjatë këtij trajnimi u trajtuan çështjet në lidhje me hetimet për shpëlarjen e parave, çështjet mbi dëshmitë e shpëlarjes së parasë, konfiskimi i parasë bazuar në mosndëshkim dhe dëshmia e dëshmitarit. Njëkohësisht në këtë trajnim u trajtua edhe Konfiskimi në bazë të mos-ndëshkimit sipas së drejtës së BE-së, krahasimi në mes të Mbretërisë së Bashkuar, Irlandës dhe Sllovakisë.

Trajnimi u përshkua nga trajtimi i rasteve praktike dhe shkëmbimi i përvojave ndërmjet trajnuesve dhe pjesëmarrësve.

Pjesëmarrës në këtë trajnim ishin: gjyqtarë të gjykatave themelore, prokurorë të prokurorive themelore nga të gjitha regjionet e Kosovës, prokurorë nga Prokuroria Speciale e Kosovës si dhe hetues policor.



Aktivitetet nga Programi i Trajnimit për Avancim (PTA)

Seminar “Procedura dhe veprimet përmbarimore në sendet monetare”



Me 4 korrik 2013, IGJK në kuadër të programit të trajnimit për profesionistët tjerë të sistemit të gjyqësisë ka realizuar një trajnim për zyrtarët përmbarues të gjykatave themelore të Kosovës me temë “Procedura dhe veprimet përmbarimore në sendet monetare”

Qëllimi i këtij trajnimi ishte krijimi i praktikave më të mira në drejtim të zbatimit të drejtë të procedurës përmbarimore me theks të veçantë lidhur me përmbarimet në llogaritë bankare të klientëve. Gjatë këtij trajnimi në detale u trajtuan konfiskimi i kontove bankare, identifikimi i llogarisë bankare dhe i debitorit, si të urdhërohet sekuestrimi i llogarisë bankare dhe transferimi i shumave, obligimet e bankave gjatë procedurës përmbarimore, përmbarimi në të ardhura personale dhe rastet speciale të mjeteve monetare të autoriteteve publike.

Përfitues të trajnimit ishin zyrtarët përmbarues nga gjitha Gjykatat Themelore të Kosovës.

Aktivitetet nga Programi i Trajnimit Fillestar (PTF)



Me **03 korrik 2013**, publikisht në ndërtesën e IGJK-së, në prani të kandidatëve dhe përfaqësuesve të OSBE-së, është bërë shpallja publike e rezultatit të Provimit Përgatitor (pjesa me shkrim), për kandidatët e gjeneratës së pastë të PTF.

Nga 93 kandidatë për gjyqtarë që iu nënshtruan provimit, mbështetur në rregullat e provimit, pjesën me shkrim e kaluan 83 kandidatë, ndërsa nga 52 kandidatë për prokurorë, 45 prej tyre e kaluan me sukses këtë provim. Këta kandidatë fituan të drejtën t'i nënshtrohen provimit me gojë.

Provimi me gojë u organizua me **5 dhe 10 korrik 2013** në ndërtesën e IGJK-së. Me 05 korrik është organizuar provimi për kandidatët

për gjyqtarë të cilit i janë nënshtruar 82 kandidatë, pasi që një kandidatë edhe pse ishte regjistruar për t'iu nënshtruar provimit, për arsye subjektive ishte tërhequr nga provimi para se ai të fillonte. Provimi me gojë për kandidatët për prokurorë është mbajtur me 10 korrik dhe me këtë rast morën pjesë 45 kandidatë. Gjatë gjithë kohës sa ka vazhduar provimi, i tërë procesi ka qenë i siguar nga roje të sigurisë.

Me **16 korrik 2013**, në IGJK në një ceremoni ku të pranishëm ishin edhe mediet, Kryetari i Këshillit Drejtues z. Fejzullah Hasani dhe Drejtori i IGJK-së z. Lavdim Krasniqi së bashku me shpalljen e rezultateve përfundimtare të Provimit Përgatitor publikuan edhe raportin detaj rreth procesit të hartimit administrimit dhe vlerësimit të

provimit përgatitor. Rezultatet e provimit u shpallën në dy lista, lista e kandidatëve për gjyqtarë dhe lista e kandidatëve për prokurorë.

Pasi ka përfunduar i tërë procesi i organizimit të Provimit Përgatitor, kandidatët që nuk e kanë kaluar provimin bazuar në Rregulloren për Programin e Trajnimit Fillestar dhe Provimit Përgatitor si dhe Rregullave për Procedurën e Organizimit të Provimit Përgatitor kanë pasur të drejtë që brenda afatit prej tri (3) ditësh të parashtrorjnë ankesat e tyre. Ankesat janë shqyrtuar nga Këshilli Programor i IGJK-së dhe është vendosur për to brenda afatit prej 5 ditësh. Ndërsa KGJK-së



dhe KPK-së (Zyrës përkatëse) i është dërguar lista e kandidatëve për verifikim përkatës, para fillimit të trajnimeve në PTF.

Programi për praktikantë-studentë të Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës



Me **23 korrik 2013** në IGJK përfunduan praktikën grupi i dhjetë i praktikantëve - studentë të Fakultetit Juridik të UP-së. Gjatë periudhës tremujore tre praktikantë ofruan mbështetje administrative në përgatitjen e materialeve të trajnimit, përmbledhjen e dokumenteve të ndryshme për realizimin e programeve trajnuese të IGJK-së, mësuan hartimin e raporteve për trajnimet përkatëse, si dhe morën pjesë në trajnime me tema që ishin në interes për ta.

Gjithashtu me kërkesë të Drejtorit të IGJK-së praktikantët punuan një program lidhur me nevojat e tyre për punë praktike në IGJK. Ky program do të shërbejë IGJK-së si një draft për përgatitjen e një programi të përhershëm për praktikantët që do vijojnë praktikën në të ardhmen në IGJK. Pas përfundimit me sukses të praktikës, Drejtori i IGJK-së u shpërndau praktikantëve certifikata.